



Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuša Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa



Në bazë të paragrafit 6 të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 si dhe nenit 63 paragrafi 63.1. pika (a) lidhur me paragrafin 63.1.2 të Rregullores 01/2022 për Prokurimin Publik, lidhur me kërkesën për rishqyrtim të datës 22.10.2024 të paraqitur nga Operatori Ekonomik “SEFERI-CO” ShPK nga Suhareka, bie këtë:

VENDIM

I

Refuzohet **si e pa bazuar** kërkesa për rishqyrtim e Operatorit Ekonomik “SEFERI-CO” ShPK nga Suhareka e parashtruar në mënyrë elektronike përmes platformës së prokurimit me datën 22.10.2024 për aktivitetin e prokurimit me numër: 626-24-10882-5-2-1 dhe nr. të brendshëm: 626-24-021-5-2-1 me titull: “Rikonstruktimi i rrugës “Bahcelik” në Mamushë”-Ritender

II

Anulohet njoftimi për pezullim të procedurës së prokurimit i datës 23.10.2024 pas paraqitjes së kërkesës për rishqyrtim.

III

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij.

ARSYETIM

Operatori ekonomik “SEFERI-CO” ShPK nga Suhareka me datë 22.10.2024 përmes platformës elektronike të prokurimit, ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim të vendimit në lidhje me njoftimin e kontratës dhe kriterëve të kërkuara për procedurën e prokurimit në fjalë nga Autoriteti Kontraktues Komuna e Maushës për projektin me titull: “Rikonstruktimi i rrugës “Bahcelik” në Mamushë”-Ritender

Si autoritet kontraktues pas pranimit të kërkesës për rishqyrtim, kemi bërë pezullimin e kësaj procedure dhe brenda afatit ligjor me kujdes të shtuar, kemi shqyrtuar të gjitha pretendimet ankimore të paraqitura në kërkesën për rishqyrtim të vendimit.

Në pretendimet e O.E. është cekur se janë bërë shkelje të neneve 1; 6; 7 dhe 69 të LPP-s. Konsiderojmë që të gjitha këto pretendime të shkeljes së LPP-s, janë të pa baza për arsyet e cekura në vijim:

Kërkesat e parashtruara në dosje të tenderit dhe njoftimin për kontratë për procedurën në fjalë sa i përket mundësive teknike dhe profesionale për kualifikimin e operatorëve ekonomik që dëshirojnë të marrin pjesë në procedurën e prokurimit në fjalë, janë të mbështetura në punët që janë paraparë në paramasë dhe parallogari si dhe në projektin ekzekutiv të bashkangjitur kësaj procedure të cilat i gjeni të bashkangjitur edhe në e-prokurim e të cilat duhet të kryhen nga kontraktuesi. Andaj tek këto kritere, nuk paraqitet asnjë kriter diskriminues ose favorizues si dhe nuk cenohet e drejta e asnjë O.E. që të ofertojë. Kriteret e përcaktuara, janë kritere minimale profesionale të natyrës së kontratës në mënyrë që përveç çmimit më të ulët të kemi edhe një operator ekonomik të përgjegjshëm, me qëllim që të ekzekutohet projekti në mënyrë profesionale. Në këtë procedurë kemi të bëjmë me një aktivitet të prokurimit me vlerë të mesme dhe nga çdo tenderues kërkohet të dëshmon që ka kapacitetin e duhur teknik dhe profesional me të cilat dëshmon dhe bind autoritetin kontraktues se mund ta ekzekuton dhe përfundon një projekt të tillë sipas afateve kohore.

Komuna e Mamushës ka lidhur memorandum të mirëkuptimit me MMPHI për financim të projektit në fjalë me datë 25.04.2024. Në memorandum janë parashikuar edhe afatet për ekzekutim të punëve dhe shpenzim të mjeteve të ndara për këtë projekt për këtë vit fiskal dhe vitet në vijim por mjetet të cilat janë destinuar për këtë vit, nuk do të mund të shfrytëzohen në vitin e ardhshëm pasi që janë destinuar për këtë vit fiskal. Andaj për realizimin e projektit në fjalë duhet të përzgjedhim operatorët ekonomik të përgjegjshëm të cilën i përmbushin kriteret e përzgjedhjes në mënyrë që të realizohet kontrata pa vonesa dhe në mënyrë profesionale.

Autoriteti Kontraktues me rastin e vendosjes së kërkesave për pjesëmarrje ka pasur kujdes të veçantë që kriteret duhet të përmbushin objektivin e natyrës së punimeve, duke u bazuar në legjislacionin e prokurimit në mënyrë që të mos ndikojnë në kufizimin e konkurrencës, por që të sigurojnë që kontraktimi dhe ofertimi i kompanive në këtë aktivitet të prokurimit të jetë i natyrës së projektit në fjalë. Pra kriteret e përzgjedhjes janë vendosur duke u bazuar në natyrën e projektit dhe duke pasur parasysh se është e nevojshme për të siguruar që vetëm OE që posedojnë aftësi të kërkuara profesionale, financiare ose teknike do të marrin pjesë në konkurrencë për kontratë. Pra kriteret e përzgjedhjes nga ana jonë janë vendosur duke u bazuar në nenin 25 të Rregullores për Prokurimin Publik nr. 001/2022 si dhe në nenin 8 të Udhëzuesit për Prokurimin Publik Nr. 001/2023.

Operatori ekonomik gjatë kërkesës për rishqyrtim në pretendimet e tij, thirret në diskriminim dhe kufizim të konkurrencës e në fakt këto pretendime nuk janë të bazuara apo të referuara në dispozita ligjore dhe në natyrën e kontratës, sepse nuk janë marrë për bazë punimet të cilat kanë për tu ekzekutuar në këtë kontratë për të ardhur në përfundimin që po diskriminohet ndonjë operator ekonomik apo po kufizohet konkurrenca. Përveç anës deklarative për më tepër këto pretendime të paraqitura në kërkesën për rishqyrtim dhe të ngritura nga ana e O.E. më tepër synojnë një përkrahim paushall që shumica e kërkesave të AK të largohen si të pa nevojshme apo të përshtaten me dokumentet që i posedon O.E në fjalë.

Andaj ne në mënyrë që të rrisim konkurrencën e kompanive serioze në këtë aktivitet të prokurimit dhe të i japim hapësirë për mundësinë e ofertimit secilit O.E. të interesuar, ne kemi lejuar që tek stafi profesional dhe tek kërkesat teknike profesionale kompanitë të cilat nuk e kanë stafin e tyre të rregullt si dhe pajisjet teknike për realizimin e kontratës t'u mundësohet angazhimi i stafit me kohë të caktuar si dhe marrja në shfrytëzim e pajisjeve të kërkuara në bazë të marrëveshjes. Pastaj, duhet pasur parasysh se kemi kërkuar pothuajse vetëm nga një inxhinier të lëmive të ndryshme sipas

punëve që kanë për tu realizuar si dhe pothuajse tek të gjitha pajisjet kemi kërkuar sasi minimale të tyre. Pra është kërkuar staf minimal i kualifikuar dhe pajisje minimale pa të cilët nuk mund të garantohet mbarëvajtja e punimeve. Gjithashtu sipas legjislacionit të prokurimit dhe dosjes së tenderit, është paraparë që tenderi mund të dorëzohet në grup nga disa operator ekonomik me qëllim që t'i përmbushin kërkesat e përcaktuara në dosje të tenderit dhe njoftimin për kontratë.

Përgjigje në Pretendimet e Operatorit Ekonomik ankues:

Në pretendimin e parë të paraqitur në kërkesën për rishqyrtim nga ana e operatorit ekonomik ankues është cekur se:

Kërkesa 2.1 O.E. duhet të caktoj me vendim menaxherin e kontratës për këtë projekt i cili duhet të jetë inxhinier i diplomuar i ndërtimit ose master të përfunduar (drejtimi konstruktiv) të ketë së paku 5 (pese) vite përvojë pune. I certifikuar për siguri dhe shëndet në punë dhe i certifikuar për mbrojtje nga zjarri si dhe të jetë specialist për organizimin dhe menaxhimin e kantierëve të ndërtimit. Në lidhje me njoftimin për kontratë dhe kërkesën e parashtruar në kriterin 2.1 O.E., dëshirojmë të konfirmojmë se caktimi i një inxhinieri të diplomuar në ndërtim, ose me master të përfunduar në drejtimin konstruktiv, dhe njëherit i cili do të jetë i angazhuar në cilësinë e menaxherit të kontratës është thelbësor për suksesin e projektit të asfaltimit. Ky menaxher kontrate do të sigurojë ekzekutimin e punëve duke aplikuar: Njohuritë e tij/saj në ndërtim dhe asfaltim et cilat janë të domosdoshme për të menaxhuar procesin e punës dhe për të garantuar cilësinë e lartë të punimeve. Me se paku 5 vite përvojë në fushën e ndërtimit, ai/ajo do të ketë njohuri të thella për sfidat që mund të shfaqen gjatë realizimit të projektit dhe do të jetë në gjendje të ofrojë zgjidhje efektive. Certifikatat për siguri dhe shëndet në punë, si dhe për mbrojtje nga zjarri, janë të domosdoshme për të siguruar një ambient pune të sigurt për të grithë punonjësit dhe për të përmbushur rregullat ligjore. Si specialist për organizimin dhe menaxhimin e kantierëve të ndërtimit, ai/ajo do të kontribuojë në koordinimin e aktiviteteve dhe burimeve, duke optimizuar proceset dhe duke minimizuar vonesat. Prandaj, angazhimi i një inxhinieri të tillë është i nevojshëm për të garantuar që projekti të realizohet me sukses dhe në përputhje me standardet e kërkuara.

- Në pretendimet e paraqitura është cekur kërkesa 2.2 Një inxhinier të diplomuar ose bachelor të Arkitekturës, kërkohet të ketë min. 3(tre) vite përvojë pune pas diplomimit në angazhime profesionale. I certifikuar për siguri dhe shëndet në punë dhe i certifikuar për mbrojtje nga zjarri. Kërkesa për një inxhinier të diplomuar ose bachelor të Arkitekturës me minimum 3 vite përvojë pune pas diplomimit është thelbësore për suksesin e projektit. Kjo përvojë siguron që inxhinieri të ketë njohuri dhe aftësi të mjaftueshme për të adresuar sfidat që mund të shfaqen gjatë procesit të asfaltimit. Po ashtu, kërkesat për certifikatat për siguri dhe shëndet në punë, si dhe për mbrojtje nga zjarri janë të nevojshme për të garantuar një ambient të sigurt dhe për të përmbushur normat ligjore. Këto certifikata tregojnë angazhimin për standarde të larta të sigurisë, duke kontribuar në parandalimin e aksidentëve dhe incidentëve të mundshëm në kantierin e ndërtimit.

- Në pretendimet e paraqitura është cekur kërkesa 2.3 Një (1) inxhinier të diplomuar ose master drejtimi Hidroteknik e cila parashikon angazhimin e një inxhinieri të diplomuar ose me master në drejtimin Hidroteknik për procedurën e tenderimit për asfaltim. Angazhimi i një inxhinieri të kualifikuar në drejtimin Hidroteknik është thelbësor për suksesin e projektit. Ky profesionist do të sjellë njohuri të thella mbi sistemet hidraulike dhe menaxhimin e ujërave, të cilat janë të rëndësishme për projektet e asfaltimit, sidomos në lidhje me drenazhimin dhe ruajtjen e cilësisë së rrugëve. Njohuritë e inxhinierëve të Hidroteknikës ndihmojnë në projektimin dhe zbatimin e

zgjdhjeve të përshtatshme për menaxhimin e ujit, çka është thelbësore për të siguruar që asfaltimi të jetë i qëndrueshëm dhe të përballojë kushte të ndryshme klimatike. Kjo ndihmon në parandalimin e dëmtimeve të shpejta dhe zgjeron jetën e shërbimit të infrastrukturës.

- Në pretendimet e paraqitura është cekur kërkesa 2.4 Një inxhinier të diplomuar ose bachelor drejtimi Gjeodezi, i licencuar me licencë valide kërkohet të ketë min. Pesë (5) vite përvojë pune pas diplomimit në angazhime profesionale. Angazhimi i një inxhinieri të kualifikuar, Inxhinierët e Gjeodezisë ose bacheror i gjeodezisë luajnë një rol kyç në procedurat e ndërtimit dhe asfaltimit. Ai është përgjegjës për matjet e sakta të rrugës dhe për hartimin e planeve të detajuar, që janë thelbësore për të siguruar një bazë të qëndrueshme për projektin. Përmes angazhimit të tij do të ndihmojë në parandalimin e problemeve të mundshme në fazat e ndërtimit dhe janë të rëndësishme për planifikimin e saktë të infrastrukturës. Angazhimi i një inxhinieri ose bachelorit me përvojë do të kontribuojë në identifikimin e sfidave të mundshme dhe në zgjidhjen e tyre përpara se ato të shfaqen në kantierin e ndërtimit. Prandaj, kërkesa për një inxhinier ose bachelor të kualifikuar në Gjeodezi është e domosdoshme për të siguruar që projekti i asfaltimit të realizohet me standarde të larta dhe të përmbushë të gjitha kërkesat teknike dhe ligjore.

- Në pretendimet e paraqitura është cekur kërkesa 2.5 Një udhëheqës i punishtes teknik i ndërtimitarisë. I certifikuar për siguri dhe shëndet në punë dhe i certifikuar për mbrojtje nga zjarri. Udhëheqësi i punishtes ka një rol të rëndësishëm në koordinimin dhe menaxhimin e aktiviteteve të ndërtimit së bashku me menaxherin e kontratë. Ai/ajo është përgjegjës për sigurinë në kantier, për zbatimin e standardeve të cilësisë dhe për mbikëqyrjen e punimeve, duke siguruar që ato të realizohen sipas planit dhe specifikimeve teknike. Certifikatat për siguri dhe shëndet në punë, si dhe për mbrojtje nga zjarri, janë thelbësore për të garantuar një ambient të sigurt për të gjithë punonjësit. Këto certifikata tregojnë angazhimin për standarde të larta të sigurisë dhe ndihmojnë në parandalimin e aksidenteve dhe incidenteve të mundshme. Prandaj, angazhimi i një udhëheqësi teknik të kualifikuar është i nevojshëm për të siguruar që projekti i asfaltimit të realizohet me sukses dhe në përputhje me rregullat e sigurisë dhe cilësisë. Kjo do të kontribuojë në efektivitetin e procesit dhe në përmbushjen e pritshmëri të të gjithë palëve të përfshira.

- Në pretendimet e paraqitura është cekur kërkesa 2.6. Një ekspert të certifikuar për sistemet e drenazhimit. I certifikuar për siguri dhe shëndet në punë dhe i certifikuar për mbrojtje nga zjarri. Ekspertët e drenazhimit janë thelbësore për garantimin e funksionalitetit të infrastrukturës rrugore, Njohuritë e tyre ndihmojnë në zbatimin e zgjidhjeve efektive për menaxhimin e ujërave, duke parandaluar përmbytjet dhe dëmtimet e mundshme të asfaltit.

- Në pretendimet e paraqitura është cekur kërkesa 2.6 Një ekspert të certifikuar për sistemet e drenazhimit. I certifikuar për siguri dhe shëndet në punë dhe i certifikuar për mbrojtje nga zjarri. Angazhimi i punëtorëve të certifikuar është thelbësor për të siguruar një ambient të sigurt dhe efektiv në kantierin e ndërtimit. Punëtorët e certifikuar janë të trajnuar për të identifikuar dhe menaxhuar rreziqet e mundshme, çka ndihmon në parandalimin e aksidenteve dhe mbrojtjen e shëndetit të tyre. Kërkesa për punëtorë të certifikuar për mbrojtje nga zjarri gjithashtu garanton se në rast të ndonjë incidenti gjatë punës, ka individë të trajnuar që dinë si të veprojnë dhe si të menaxhojnë situatën. Kjo është veçanërisht e rëndësishme në projekte si asfaltimi, ku temperatura e lartë dhe materialet e përdorura mund të paraqesin rreziqe. Prandaj, angazhimi i dhjetë (10) punëtorëve të rregullt të certifikuar është një kërkesë e nevojshme për të siguruar që projekti i asfaltimit të realizohet në mënyrë të sigurt dhe efektive. Kërkesa për një numër të caktuar

punëtorësh të certifikuar nuk është një kërkesë kufizuese, por një mase për të siguruar që projekti të realizohet në përputhje me standardet e larta të sigurisë bazuar në Ligjin 04/L-161 Për Sigurinë dhe Shëndetin në Pune dhe në bazë të Nenit 7 i LPP-së thekson nevojën për trajtim të barabartë dhe jo-diskriminues të operatoreve ekonomik, dhe kjo kërkesë nuk e ul konkurrencën, por përkundrazi, e rrit atë duke siguruar që të gjithë operatorët të angazhohen punëtorë të kualifikuar dhe të trajnuar. Prandaj, kërkesa për dhjetë (10) punëtor të certifikuar është e justifikuar dhe e nevojshme për realizimin e sigurt dhe efektiv të projektit të asfaltimit.

Përdorimi i një ngjethëse hidraulike, Makinë ngjeshës max. 70 kg garanton ngjeshjen e duhur të materialeve, duke parandaluar krijimin e boshllëqeve dhe ndihmuar në stabilizimin e sipërfaqeve, që është esenciale për qëndrueshmërinë e asfaltit për një periudhë më të gjatë kohore.

Dumperi 2.5 ton është i nevojshëm për transportimin efikas të materialeve ndërtimore, si asfalt, granula dhe materialet e tjera të nevojshme për realizimin e projektit. Peshë e specifikuar e pajisjes e bën atë të përshtatshme për lëvizjen e materialeve në kushte të ndryshme terreni.

Spërkatësja me kapacitet maksimal 2 ton është kërkuar për të siguruar një shpërndarje të barabartë dhe të kontrolluar të bitumenit dhe emulsionëve, të cilat janë kritike për krijimin e një sipërfaqe të qëndrueshme dhe cilësore si dhe duke e pasur parasysh vendin, hapësirën e ekzekutimit të kontratës është një pajisje e cila është adekuate për atë hapësirë.

Grejderi nivelizues digjital është i nevojshëm për të siguruar një nivelizim të saktë dhe të barabartë të sipërfaqeve për asfaltimin, duke garantuar që struktura e rrugës të përmbushë standardet e kërkuara për stabilitet dhe qëndrueshmëri. Përdorimi i një grejderi me kapacitet të tillë ndihmon në optimizimin e procesit të ndërtimit, duke lejuar që punimet të kryhen shpejt dhe me saktësi, duke reduktuar nevojën për punë shtesë.

Freza hidraulike me kapacitetin e specifikuar është e nevojshme për të siguruar një gërryerje të thellë dhe efikase të materialeve, siç janë gurët, betoni dhe asfalti në punët e urës saktësisht të poz. 2.03, duke përmirësuar cilësinë e punimeve dhe duke lejuar përgatitjen e sipërfaqeve për asfaltim. Përdorimi i një freze me këtë kapacitet ndihmon në përshpejtimin e procesit të ndërtimit, duke lejuar që punimet të kryhen shpejt dhe me saktësi, çka është thelbësore për përmbushjen e afateve të projektit ashtu siç e kemi cekur edhe në FTD dhe njoftimin për kontratë që plani dinamik i punimeve është një afat i kufizuar.

Freza montuese ndihmon në gërryerjen e sakte të asfaltit, gurit dhe betonit, pasi duke siguruar një sipërfaqe të përgatitur mirë për asfaltim, çka është thelbësore për cilësinë dhe qëndrueshmërinë e punimeve. Me peshën e specifikuar, kjo pajisje është e nevojshme dhe e përshtatshme për përdorim në terrene të ndryshme saktësisht në pozicionin 2.03 dhe për operacione të ndryshme, duke lejuar fleksibilitet gjatë procesit të ndërtimit.

Makinerinë për vendosje të kabëzave të betonit min. 1.5 tonë është kyçe për stabilitetin dhe funksionalitetin e infrastrukturës rrugore. Përdorimi i një makinerie me këtë kapacitet ndihmon në përshpejtimin e procesit të ndërtimit, duke lejuar që punimet të kryhen më shpejt dhe me më pak burime njerëzore.

Pajisja vakum ngritëse për vendosje te anësoreve minimum 500 kg Kjo pajisje lejon ngritjen dhe vendosjen e anësoreve të betonit ne mënyre te sigurt dhe efikase, duke minimizuar rrezikun e dëmtimeve dhe duke garantuar një përputhje të saktë me projektin. Përdorimi i pajisjes vakum ndihmon në përshpejtimin e procesit të vendosjes, duke reduktuar nevojën për pune manuale dhe duke siguruar një rezultat të qëndrueshëm dhe të saktë.

Kompresori ajrit i montuar mbi një shasi me rrota është shumë i nevojshëm gjatë punimeve në asfaltim ku pames tij do të ofrohet të realizohet procesi si shpimet, ndihmës ne nivelimin e sipërfaqeve, ose në aplikimin e materialeve. Kompresori i lëvizshëm, lejon lëvizje te lehte dhe të shpejtë midis vendeve të punës. Po ashtu, kapaciteti i tij për të ofruar ajër të kompresuar në mënyrë të vazhdueshme ndihmon në rritjen e efikasitetit dhe produktivitetit gjatë punimeve.

Sa i përket pretendimit se janë shkelur dispozitat e nenit 7 të LPP-së, konsiderojmë që edhe ky pretendim është i pa bazë pasi që ne, me rastin e vendosjes së kërkesave kemi pasur qëllimin që të sigurohemi që operatorët ekonomik pjesëmarrës t'i plotësojnë kërkesat minimale të kërkuara në mënyrë që të jenë në gjendje ta realizojnë projektin në fjalë. Gjithashtu pa kurrfarë diskriminimi, kemi zbatuar procedurën e hapur për prokurimin në fjalë të cilën e kemi udhëhequr në mënyrë transparente dhe jo diskriminuese, në përputhje të plotë me legjislacionin e prokurimit në fuqi. Gjithashtu të gjitha dokumentet e procedurës janë ngarkuar në platformën e-prokurimi dhe në ueb-faqe të Komunës së Mamushës, andaj është për tu habitur pretendimi i O.E. ankues se procedura nuk është zhvilluar në mënyrë transparente!

Aktiviteti i prokurimit është udhëhequr në përshtatje të plotë me dispozitat e nenit 4 paragrafi 4.3 të Rregullores për prokurimin publik 001/2022 të cilat parashohin:

Citat: “Të gjitha aktivitetet e prokurimit do të udhëhiqen në pajtim me parimet bazike si në vijim:

- a. Konkurrenca – në mesin e Operatorëve Ekonomik duhet të inkurajohet në mënyrën më efikase dhe me efektive.
- b. Efikasiteti & Efektiviteti – duhet të dëshmohet në procesin e prokurimit për të siguruar vlerën për paranë për Autoritetin Kontraktues.
- c. Drejtësia/Mos-diskriminimi – Të vepohet në mënyrë të drejtë gjatë tërë ciklit të prokurimit pa imponuar obligime të panevojshme ose pengesa për Operatori Ekonomik ose Operatori Ekonomik potencial. Të shmanget çdo trajtim që favorizon një furnizues të caktuar ose furnizues potencial.
- d. Objektivitet/Integritet/Sinqeritet – Të deklarohet çdo konflikt i interesit që afekton ose paraqet afektim të vendimit; Të refuzohen dhurata, mikpritje dhe benefit të çfarëdo lloji nga Operatori Ekonomik ose Operatori Ekonomik potencial, të cilat mund të paraqesin kompromitim të objektivitetit ose integritetit.
- e. Transparenca – Të sigurohen kushte dhe qasje të barabartë për të gjithë OE-të, duke informuar ata në mënyrë të hapur dhe transparente.
- f. Llogaridhënie – Të ketë llogaridhënie për përgjegjësitë e përcaktuara, si dhe për vendimet e nxjerra, dhe regjistrimin e të dhënave të nevojshme.

g. Profesionalizëm – Të punohet me standarde të larta profesionale duke respektuar legjislacionin në fuqi dhe duke aplikuar praktikat më të mira.”

Sikur shihet në kërkesën për rishqyrtim të paraqitur nga ana e O.E. ankues, i njëjti nuk ka paraqitur asnjë dëshmi apo fakt të vetëm i cili do të dëshmonte shkelje të dispozitave të lartcekura, andaj konsiderojmë që edhe ky pretendim është i pa bazë.

Operatori Ekonomik ankues ka pretenduar se janë shkelur edhe dispozitat e nenit 1 të LPP-së. Edhe ky pretendim është i pa qëndrueshëm, pasi që ne si Autoritet Kontraktues i kemi respektuar të gjitha dispozitat ligjore të legjislacionit të Prokurimit Publik, për tu siguruar që kjo procedurë të zhvillohet në mënyrën më efikase dhe më ekonomike. Gjithashtu gjatë kësaj procedure, janë zbatuar të gjitha parimet e LPP-s duke siguruar mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Republikën e Kosovës. Prandaj na del se ne si AK nuk i kemi shkelur dispozitat e nenit 1 të LPP-s por i kemi respektuar me përpikëri dispozitat në fjalë.

Andaj,

Duke u bazuar në atë që u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Mamushë, me dt 25.10.2024

Gazmend Gashi
Udhëheqësi i sektorit të prokurimit
Komuna e Mamushës



Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të parashtroj ankesë pranë **Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP)** brenda afatit prej 10 (dhjetë) ditëve pas vendimit të lëshuar nga Autoriteti Kontraktues.